

Bashkimi Evropian

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut Kosovë

Raport vjetor

1 janar - 31 dhjetor 2014

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - Sekretariati

Rr. Rustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +38 28 2125

Email: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Parathënie..... | 4 |
| 1. Hyrje..... | 6 |
| 2. Korniza rregulluese | 7 |
| 2.1. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 lidhur me Misionin Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i KOSOVOË | 7 |
| 2.2. Koncepti llogaridhënës i EULEX-it Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009..... | 7 |
| 2.3. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut..... | 7 |
| 3. Paneli dhe Sekretariati..... | 9 |
| 3.1. Anëtarët e Panelit | 9 |
| 3.2. Sekretariati..... | 11 |
| 4. Numri i lëndëve dhe subjekti i ankesave | 13 |
| 4.1. Numri i lëndëve dhe statistikat..... | 13 |
| 4.2. Trendët..... | 13 |
| 4.3. Subjekti i ankesave..... | 14 |
| 5. Jurisprudenca | 14 |
| 5.1. Meritat | 14 |
| 5.1.1. <i>Zahiti kundër EULEX-it</i> – obligimi i EULEX-it për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe për të siguruar një zgjidhje efektive juridike në rast të shkeljeve të pretenduara | 14 |
| 5.1.2. <i>Goran Becic kundër EULEX-it</i> – obligimi i EULEX-it për të regjistruar dhe për të shqyrtuar ankesat që përfshijnë akuzat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut | 16 |
| 5.1.3. <i>Mirko Krlic kundër EULEX-it</i> – obligimet pozitive të EULEX-it për ta mbrojtur të drejtën e ankuesit që t'i respektohet jeta e tij private | 17 |
| 5.2. Pranueshmëria..... | 18 |
| 5.2.1. Kompetenca e Panelit për shqyrtimin e procedurave të gjykatave në Kosovë | 18 |
| 5.2.2. Ri-shqyrtimi i një ankese | 19 |
| 5.3. Vendimet pasuese..... | 19 |
| 6. Aktivitetet e Panelit | 20 |
| 6.1. Fushata informuese e vitit 2014 | 20 |
| 6.2. Trajnimi hyrës për personelin e EULEX-it..... | 20 |
| 6.3. Faqja e internetit e PShDNj-së | 21 |
| 8. Vërejtjet përfundimtare..... | 22 |
| SHTOJCA 1 Tabela e personelit..... | 24 |
| SHTOJCA 2 Statistikat 2010 - 2014 | 25 |
| SHTOJCA 4 Vendimet e PShDNj-së 2010-2014..... | 26 |
| SHTOJCA 4 Orari i fushatës informuese dhe aktivitetet e tjera..... | 32 |

Parathënie

Ky është raporti i pestë vjetor i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (më tutje: "Paneli"). Si në vitet e mëparshme, Paneli ka vazhduar gjatë gjithë periudhës raportuese me shqyrtimin e ankesave të shkeljeve të të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtësi, polici dhe doganë.

Në vitin 2014, Paneli ka mbajtur pesë seanca dhe ka shqyrtuar 35 ankesa.

Në dy nga këto lëndë, Paneli ka konstatuar se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut. Shkeljet nga EULEX-i kanë të bëjnë me mosveprim nga ana e Misionit, të cilat kanë rezultuar në shkeljet e të drejtave të njeriut të ankuesit, e jo të akteve pozitive që i ngarkohen Misionit. Në të dy këto raste, Paneli ka konstatuar se EULEX-i nuk kishte arritur t'ju sigurojë ankuesve zgjidhje efektive juridike ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut. Kjo ka rezultuar në shkelje të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila garanton të drejtën në zgjidhje efektive juridike për të gjithë ata, të cilëve ju janë shkelur të drejtat dhe liritë. Paneli ka paraqitur rekomandime për shefin e Misionit të EULEX-it në Kosovë për t'i adresuar këto shkelje.

Në katër lëndë të tjera, Paneli ka nxjerrë vendime pasuese për zbatimin e rekomandimeve nga ana e shefit të Misionit. Këto vendime janë diskutuar më tutje në mënyrë të hollësishme në këtë raport.

Paneli ka shpallur 23 ankesa të tjera të papranueshme.

Gjatë periudhës raportuese, Paneli ka pasur një rritje të konsiderueshme në numrin e lëndëve, ku janë pranuar 42 ankesa të reja.

Paneli dhe Sekretariati po ashtu kanë vazhduar fushatën informuese me qëllim të shpërndarjes së informacionit në lidhje me mandatin e tij. Paneli ka përqëndruar përkjekjet e tij kryesisht në gjyqësorin e Kosovës, në OJQ-të që merren me të drejta të njeriut dhe ndihmë juridike, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe në organizma fetarë në Kosovë. Paneli dhe Sekretariati gjithashtu kanë marrë pjesë në intervista dhe debate në media, seminare të ndryshëm për të drejtat e njeriut, konferenca dhe tryeza të rrumbullakëta. Në vitin 2014 ka nisur një fushatë informuese e shumëpritur, me një spot të shkurtë, që i shpjegon publikut rolin edhe funksionin e Panelit.

Paneli gjithashtu ka vazhduar me takime periodike me shefin e Misionit, zëvendës shefin e Misionit dhe zyrtarë të tjerë të lartë të EULEX-it, në mënyrë që të garantohet puna efektive e funksioneve të tij për të siguruar bashkërendimin e shpejtë dhe të kujdesshëm të organeve përkatëse të Misionit.

Një buletin i rregullt elektronik, i cili ka filluar në vitin 2012, ka dëshmuar të jetë mjeti më i suksesshëm në ofrimin e informacionit mbi Panelin dhe në ngritjen e vetëdijesimit publik për mandatin dhe punën e tij. Çdo edicion i dërgohet më shumë se një mijë personave, institucioneve dhe mediave.

Megjithatë, duhet theksuar se pavarësisht nga aktivitetet e tij të gjera në terren, ende ka një mungesë të njohjes së ekzistencës së Panelit dhe mandatit në fushën e Misionit. Paneli ka për qëllim të ndërmerë hapa shtesë që me ndihmën e Misionit të rris pamjen e vet.

Po ashtu ka pasur edhe disa ndryshime në personelin e Sekretariatit të Panelit, ku janë larguar zyrtari i lartë ligjor, z. John Ryan dhe zyrtari ligjor, z. Florian Razesberger nga pozitat e tyre.

Dëshiroj të shfrytëzosh këtë mundësi të shpreh falënderimin tim për të gjithë anëtarët e Panelit dhe të Sekretariatit për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm në punën e Panelit gjatë periudhës raportuese.

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut do të dëshironte të përshëndes bashkëpunimin e shefit të Misionit në punën e Panelit. Në veçanti, Paneli do të donte të përgëzonte shefin e Misionit në përpjekjet e tij për të kërkuar që t'i respektoj dhe zbatoj rekomandimet e Panelit në lëndët ku janë gjetur se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut.

Së fundi, do të dëshiroja të shfrytëzosh këtë mundësi për të paraqitur vlerësimin tonë lidhur me bashkëpunimin e mirë që Paneli ka pasur deri më tani me shefin e Misionit të EULEX-it dhe me tërë EULEX-in Kosovë.

Magda Mierzevska
Kryesuese
Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

1. Hyrje

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, i themeluar nga Bashkimi Evropian më 29 tetor 2009, ka vazhduar me shqyrtimin e shkeljeve të dyshuara të të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv gjatë tërë vitit të katërt të punës në vitin 2014.

Paneli është i pari dhe deri më tani mekanizmi i vetëm llogaridhënës i të drejtave të njeriut që merret me shkeljet e dyshuara të të drejtave të njeriut nga një mision i Sigurimit të Përbashkët dhe Politikës së Mbrojtjes të Bashkimit Evropian. Së bashku me Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të Misionit të Kombeve të Bashkuara të Administratës së Përkohshme në Kosovë (UNMIK), Paneli është një prej vetëm dy Paneleve ndërkombëtare që i mbajnë organizatat ndërkombëtare përgjegjëse për shkeljet e të drejtave të njeriut. Zgjerimi i llogaridhënies për shkeljet e të drejtave të njeriut prej shteteve tek organizatat ndërkombëtare paraqet një përparim të madh në zhvillimin e mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që gjen njohje ndërkombëtare në rritje e sipër. Në momentin e duhur, Paneli mund të jetë element i domosdoshëm i punës së organizatave ndërkombëtare, e në veçanti i misioneve për sundimin e ligjit.

Ky raport përshkruan veprimtaritë e Panelit për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2014. Raporti përqendrohet kryesisht në numrin e lëndëve të Panelit dhe jurisprudencën që është në zhvillim e sipër. Më tej, aty janë përshkruar në hollësi përpjekjet e Panelit sa i përket aktiviteteve informuese në terren.

Gjatë periudhës raportuese, Paneli ka mbajtur pesë seanca dhe ka shqyrtuar tridhjetë e pesë lëndë. Paneli ka gjetur njëzet e dy lëndë të papranueshme, një lëndë e ka gjetur të pranueshëm, ku ka gjetur se aty ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut në lidhje me dy ankues. Paneli ka komunikuar trembëdhjetë lëndë tek shefi i Misionit për vërejtje në lidhje me pranueshmërinë dhe meritat e tyre.

Në lëndët ku janë gjetur shkelje të të drejtave të njeriut, Paneli ka paraqitur tek shefi i Misionit të EULEX-it Kosovë rekomandime të hollësishme me qëllim të korrigjimit të atyre shkeljeve. Paneli po ashtu ka vlerësuar përgjigjen pasuese të EULEX-it Kosovë ndaj rekomandimeve dhe në një rast ka paraqitur rekomandime të tjera si pjesë e rekomandimeve pasuese.

Në vitin 2014, Paneli ka parë një rritje të konsiderueshme të paraqitjes së numrit të ankesave. Paneli ka regjistruar 42 ankesa të reja të tilla, në krahasim me 27 ankesa sa ishin në vitin 2013. Kjo rritje e konsiderueshme mund t'i atribuohet në pjesë të madhe informacionit më të madh rreth Panelit dhe rolit të tij në publik, e po ashtu edhe falë përpjekjeve të Panelit në fushatën informuese. Transmetimi i një spoti televiziv, përgatitur nga Zyra për Shtyp dhe Informim Publik i EULEX-it, në kanalet informative në Kosovë, gjatë periudhës janar-shtator 2014, gjithashtu ka kontribuar shumë në këtë rritje të informimit.

Në përfundim të vitit të pestë të punës, Paneli është i kënaqur që ka vazhduar të kontribuojë pozitivisht në pozitën e EULEX-it si Mision i angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.

2. Korniza rregulluese

2.1. Veprimi i përbashkët i Këshillit 2008/124/CFSP i datës 4 shkurt 2008 lidhur me Misionin Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i KOSOVË

Veprimi i Përbashkët i Këshillit është burim i autoritetit dhe kompetencës së misionit të EULEX-it në Kosovë. Ai përcakton mandatin e EULEX-it dhe ndër të tjera saktëson llogaridhënien e tij lidhur me të drejtat e njeriut në nenin 3 (i): *“të sigurojnë që të gjitha aktivitetet e tij respektojnë standardet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore”*.

2.2. Koncepti llogaridhënës i EULEX-it Kosovë – Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, Bruksel, i datës 29 tetor 2009

Krijimi i një mekanizmi efektiv dhe transparent i të drejtave të njeriut është cilësuar të jetë një nevojë thelbësore për EULEX-in Kosovë, si Mision për Sundimin e ligjit, të cilat u janë dhënë disa funksione të kufizuara ekzekutive. Një mekanizëm i tillë i jashtëm llogaridhënës do të shërbejë për të plotësuar llogaridhënien e përgjithshme të EULEX-it në Kosovë, siç ofrohet nga Polica e Sigurimeve të Përgjegjësishë ndaj Palës së Tretë dhe nga Njësia e Hetimeve të Brendshme të EULEX-it në Kosovë, të cilat janë themeluar që në fillim.

Në këtë mënyrë, Koncepti llogaridhënës përcakton mandatin e Panelit për të shqyrtuar ankesat nga secili person, i cili pretendon se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it Kosovë gjatë kryerjes së mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë¹. Sidoqoftë, sipas këtij Koncepti, Paneli nuk ka juridiksion mbi gjykatat e Kosovës. Për më tepër, Paneli kanë gjetur se fakti që gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues nuk e ndryshon karakterin e këtyre gjykatave, si gjykata të Kosovës (për më shumë hollësi shih par. 5.2.1 më poshtë).

Paneli ka miratuar Rregulloren e vet të Punës me datën 10 qershor 2010, prej kur edhe është autorizuar të pranojë ankesa. Paneli ka ndryshuar rregullat e veta më 21 nëntor 2011 dhe më 15 janar 2013.

2.3. Instrumentet e zbatueshme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

Sipas dispozitave të Konceptit llogaridhënës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e dyshuara, në mesin e të tjerave edhe të këtyre instrumenteve të të drejtave të njeriut:

- Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut (1948);
- Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore (KEDNj, 1950);
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit Racor (KEDR, 1965);
- Konventa Ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike (KDCP, 1966);
- Konventa Ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore (KDEShK, 1966);
- Konventa për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Gruas (KEDG, 1979);

¹Koncepti llogaridhënës është pjesë e planit operativ të EULEX-it. Për këtë arsye konsiderohet një dokument i kufizuar dhe kështu nuk është i hapur për publikun.

- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (KKT, 1984);
- Konventa Ndërkombëtare mbi të drejtat e Fëmijës (KDF, 1989).

Në praktikë, ankesat e parashtruara deri më tani kryesisht janë bazuar në nenet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) dhe Protokollet e saj. Një numër i tyre gjithashtu janë bazuar në dispozitat e Deklaratës për të Drejtat e Njeriut, Konventat ndërkombëtare dhe instrumentet e tjera të të drejtave të njeriut.

3. Paneli dhe Sekretariati

3.1. Anëtarët e Panelit

Paneli përbëhet prej katër anëtarëve, përfshirë kryesuesen e Panelit. Një prej anëtarëve të Panelit është po ashtu gjykatëse e EULEX-it. Kjo gjykatëse ka një anëtar zëvendësues.

Kryesuesja

Znj. Magda Mierzewska, shtetase e Polonisë, ka kaluar Provimin Shtetëror të Polonisë për poste gjyqësore në vitin 1982. Ajo u pranua në Odën e Këshilltarëve Juridik të Gdanskut në vitin 1989 dhe ka arritur shkallën e magjistrisë të drejtësisë (LLM) në të Drejtën e Bashkimit Evropian në Universitetin Leicester në vitin 2005.

Ajo u emërua juriste rreth lëndëve në Sekretariatit e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasburg në vitin 1993. Pastaj, nga viti 1998 ajo ishte punësuar si juriste në Sekretariatit e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, Francë. Ajo ka përvojë të gjerë ndërkombëtare të trajnimit në çështje të ndryshme thelbësore dhe procedurale të të drejtave të njeriut.

Publikimet e shumta akademike të znj. Mierzewska përfshijnë: *Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut: Dhjetë vite pas Ratifikimit, Zyra për Informim e Këshillit të Evropës në Varshavë, 2004; Dhjetë vjet më pas: Popullariteti i Konventës në Poloni (bashkë-autore), Revista e Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi i 4, 2004; Dhjetë vjet më pas: Praktika gjyqësore polake voluminoze dhe interesante (bashkë-autore), Revista e Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi 5, 2004; Standardet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastet lidhur me shpronësimet dhe aplikimin e tyre për kërkesat pronësore gjermane, Instituti Polak për Marrëdhënie ndërkombëtare, 2005; Procesi i pranimi të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në Poloni dhe Sllovakia në: Pranimi i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, botimet. H. Keller, A. Stone-Sweet, Oxford University Press, maj 2008; Konsistenca e praktikës gjyqësore si çështje e të drejtave të njeriut në jurisprudencën e Gjykatës evropiane të të drejtave të njeriut, në: *Cohérence et impact de la jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme, Liber amicorum Vincent Berger*, 2013.*

Anëtarët

Prof. Dr. Guénael Mettraux

Dr. Guénaël Mettraux ka diplomuar për juridik (*licence en droit*) në Universitetin e Lozanës (Zvicër), ka magjistruar për juridik (LLM) në të drejtën ndërkombëtare nga Kolegji Universitar i Londrës dhe ka doktoruar në Shkollën londineze të ekonomisë dhe shkencave politike.

Ai punon avokat dhe konsulent pranë gjykatave penale ndërkombëtare (ICTY, ICC, STL dhe ECCC). Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, ai ka përfaqësuar disa udhëheqës të lartë ushtarak dhe civil, të akuzuar për krime ndërkombëtare. Ai ka këshilluar qeveri dhe OJQ rreth çështjeve të ndryshme lidhur me regjimet rregullatore, gjykimet penale, ligjet dhe drejtësinë tranzicionale. Dr. Mettraux tani është profesor në Universitetin e Amsterdimit (Holandë) dhe ligjërues mysafir në Universitetin e Friburgut në Zvicër.

Ai ka bërë publikime të shumta në fushën e së drejtës ndërkombëtare. Puna e tij shkencore përfshinë tri libra: *International Crimes and the ad hoc Tribunals (Krimet Ndërkombëtare dhe Tribunalet ad hoc)* (Oxford University Press, 2005), *Perspectives on the Nuremberg Trial (Perspektiva rreth Gjyimit të Nyrembergut)* (Oxford University Press, 2008) dhe *The Law of Command Responsibility (Ligji mbi përgjegjësinë komanduese)* (Oxford University Press, 2009), e cila ka marrë çmimin Lieber nga *American Society of International Law (Shoqata Amerikane e së Drejtës Ndërkombëtare)*. Dr. Mettraux-i është anëtar i Komisionit Redaktues të *Revistës të së Drejtës Ndërkombëtare* dhe i Këshillit Redaktues të *Revistës të së Drejtës Penale Ndërkombëtare*.

Dr. Katja Dominik

Dr. Katja Dominik, shtetase e Gjermanisë, ka studiuar drejtësinë dhe gjuhët sllave në Universitetin e Goettingen-it në Gjermani, ku ka diplomuar në vitin 1996.

Dr. Domenik ka marrë bursë pasdiplomike, ku ka përfunduar studimet rreth aspekteve ligjore të shpërbërjes së shtetit të ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë në Zagreb, Kroaci në vitin 1998/99. Disertacioni i saj ishte botuar në vitin 2001.

Nga viti 2000 deri në vitin 2002 ajo ka punuar si nëpunëse ligjore në Gjykatën e Lartë Rajonale në Dyseldorf dhe gjithashtu në zyrën e avokatisë, e specializuar në ligjin për azil. Në vitin 2002 ajo u punësua nga Ministria Federale Gjermane e Bashkëpunimit dhe Zhvillimit Ekonomik në Bon, ku kishte punuar në Divizionin për politikë zhvillimore evropiane. Në këtë cilësi, ajo ka hulumtuar dhe përpiluar tekste dhe fjalime për konferenca ndërkombëtare për ndihmë zhvillimore në Bruksel dhe Bon, ku ajo gjithashtu në disa raste ka përfaqësuar qeverinë gjermane.

Në tetor të vitit 2002, Dr. Domenik është emëruar gjykatëse në Gjykatën e Qarkut në Dyseldorf, ku është specializuar në lloje të ndryshme të ligjit penal. Më pas, ajo ishte bërë zëvendëse kryetare në dhomën penale të Gjykatës së Qarkut për krime të rënda kapitale dhe krime ekonomike.

Dr. Dominik është emëruar gjykatëse ndërkombëtare në EULEX Kosovë në tetor të vitit 2011, ku më pas është caktuar në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës, ku merret me raste të krimeve të luftës të një profili të lartë, vrasje, korrupsion dhe trafikim të qenieve njerëzore. Shefi i misionit të EULEX-it ka emëruar dr. Domenik-un anëtare të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të Bashkimit Evropian në janar të vitit 2013.

Anëtarja zëvendësuese

Znj. Elka Filcheva-Ermenkova

Znj. Elka Filcheva-Ermenkova, shtetase bullgare ka studiuar për drejtësi në Universitetin e Blagoevgrad-it, Bullgari ku ka diplomuar në vitin 1997. Ajo është përqendruar në studimet e të drejtave të njeriut gjatë shkallës së masterit dhe më vonë ka përfunduar kurse të shumta lidhur me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj) dhe Protokollet e saj. Pas përfundimit të stazhit të saj pas-universitar, në tetor 1998 ajo është emëruar gjykatëse e re në Gjykatën e Qarkut, Blagoevgrad në një panel të ankimit, ku nën mbikëqyrjen e dy gjykatësve të Gjykatës së Qarkut ajo ka kryesuar lëndë në të gjitha prej këtyre çështjeve: civile, të së drejtës penale dhe administrative. Në vitin 2001 ajo është emërua gjykatëse në Gjykatën Rajonale të Ligjit në Blagoevgrad ku ka kryesuar çështjet civile dhe penale. Në vitin 2003 ajo është emëruar kryetare e Gjykatës Rajonale në Blagoevgrad.

Në vitin 2004, ajo është emëruar gjykatëse e Gjykatës së Qarkut në shkallën e dytë, ndërsa ka punuar edhe si gjykatëse e shkallës së parë dhe gjykatëse e apelit në çështjet civile dhe penale, me theks kryesor në çështjet civile.

Në janar të vitit 2008, ajo është dërguar në Këshillin e Bashkimit Evropian (BE), në departamentin për Planifikim Civil dhe Mundësi Operacionale (PCMO) si këshilltare për sundim të ligjit, ku ka punuar deri në janar të vitit 2012. Në janar 2012 është emëruar gjykatëse ndërkombëtare në Komisionin për ankesa për ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës. Ajo është emëruar zëvendëse anëtare e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të Bashkimit Evropian nga shefi i Misionit të EULEX-it më 15 janar 2013.

3.2. Sekretariati

Sekretariati i Panelit përbëhet prej një zyrtari të lartë ligjor, dy zyrtarë ligjor, një asistente administrative/gjuhësore dhe dy interpret/përkthyes.

Znj. Joanna Marszalik, shtetase e Polonisë, ka diplomuar për Drejtësi në nivelin master nga Universiteti i Jagiellonian-it në Krakow, Poloni. Për pesë vite ajo ka punuar juriste në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, Francë. Më pas ajo ishte menaxhere e projektit për Këshillin e institutit të Evropës në projektin ndërtues institucional “Mbështetja për Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë” dhe udhëheqëse ekipi e këshillit të Evropës dhe projektit të Bashkimit Evropian “Transparenca dhe Efikasiteti i Sistemit Juridik në Ukrainë”, e cila ka mbështetur reformat e sistemit juridik të Ukrainës. Ajo iu bashkua misionit të OSBE-së në Kosovë në dhjetor të vitit 2010, ku punoj si zyrtare e lartë e të drejtave të njeriut, duke mbikëqyrur Qendrën Rajonale në Prishtinë. Ajo u emërua si zyrtare ligjore në Sekretariatit e Panelit në prill të vitit 2012.

Znj. Shpresa Gosalci, shqiptare e Kosovës, ka diplomuar në Universitetin AAB, Prishtinë, në degën e gjuhës dhe letërsisë angleze. Ajo ishte punësuar si përkthyes (shqip/serbisht/anglisht) në KFOR nga korriku i vitit 1999 deri në qershor të vitit 2000, si dhe si asistente administrative/gjuhësore në Zyrën e Informimit Publik dhe Media të Komisionarit të Policisë së UNMIK-ut nga qershori i vitit 2000 deri në mars të vitit 2009. Ajo është asistente administrative/gjuhësore në Sekretariatit e Panelit që nga korriku i vitit 2010.

Znj. Katica Kovaçević, serbe e Kosovës, ka qenë e punësuar më parë si asistente administrative/gjuhësore (serbisht/anglisht) në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm nga maji i vitit 2003 deri në dhjetor të vitit 2008 dhe si asistente gjuhësore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nga janari i vitit 2009 deri në nëntor të vitit 2010. Ajo filloj punën si interprete/përkthyes në Sekretariatit e Panelit në dhjetor të vitit 2010.

Z. Kushtrim Xhaferi, shqiptar i Kosovës, ka diplomuar në Universitetin e Prishtinës, Kosovë, në degën e gjuhës dhe letërsisë angleze. Ai më parë ka punuar si interpret/përkthyes (shqip/anglisht) në Korporatën Energjetike të Kosovës nga shkurti i vitit 2004 deri në janar të vitit 2009, e më pas si asistent gjuhësor në Komponentin e Policisë së EULEX-it. Ai punon si interpret/përkthyes në Sekretariatit që nga shtatori i vitit 2010.

Ish personeli i Sekretariatit, të cilët kanë shërbyer gjatë vitit 2014

Z. John J. Ryan, shtetas i Irlandës, ka diplomuar në juridik me titullin Bachelor (Hons) për Drejtësi dhe Studime Evropiane nga Universiteti i Limerick-it, Irlandë dhe ka diplomë pasuniversitare si avokat nga Shoqata e Avokatëve të Irlandës. Ai ka punuar si avokat me Stephen MacKenzie dhe Co.

Solicitors, në Dublin, Irlandë. Ai ka shërbyer në Kombet e Bashkuara në Liban, Siri, Izrael, Kamboxhia, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni, Timor lindor, Nepal, Kosovë dhe në Komisionin Evropian në Kinë. Para se të merrte detyrën e tij të tanishme, kishte punuar në UNMIK, ndër të tjera si administrator në Komunën e Zveçanit në regjionin e Mitrovicës, shef i Divizionit për Mbështetje Gjqësore Ndërkombëtare - Departamenti i Drejtësisë, këshilltar ligjor, Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm të Kombeve të Bashkuara (O/PSSP) - UNMIK, dhe zyrtar ekzekutiv, Paneli Këshillëdhënës i të Drejtave të Njeriut të UNMIK-ut. Ai është emëruar zyrtar i lartë ligjor dhe shef i Sekretariatit të Paneli në prill 2010. Artikulli i tij rreth Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë është botuar në Revistën e Forcave të Mbrojtjes së Irlandës në vitin 2010. Z. Ryan ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij në dhjetor të vitit 2014.

Z. Florian Razesberger, shtetas i Austrisë, ka studiuar për juridik në Universitetin e Vjenës, Kopenhagës dhe Innsbruck-ut. Ai fillimisht ka punuar si nëpunës ligjor në Gjykatën Rajonale të Innsbruck-ut dhe është emëruar asistent zyrtar ligjor brenda Presidencës dhe Dhomës së Gjykatës Penale Ndërkombëtare në Hagë. Më pastaj, ai u emërua këshilltar ligjor në OJQ-në britanike për ndihmë ligjore “Africa Middle East Refugee Assistance” në Kajro, Egjipt. Më pas, ai është emëruar këshilltar ligjor në misionin e OSBE-së në Shkup dhe Sarajevë. Më pas, ai u emërua zyrtar për të drejtat e njeriut dhe udhëheqës ekipi për misionin e asistencës së Kombeve të Bashkuara në Afganistan. Z. Razesberger iu është bashkuar EULEX-it Kosovë si ekspert i të drejtave të njeriut para se të emërohej zyrtar ligjor në Sekretariatit e Panelit në shtator të vitit 2012. Z. Razesberger ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij në dhjetor të vitit 2014.


4. Numri i lëndëve dhe subjekti i ankesave

4.1. Numri i lëndëve dhe statistikat


Në vitin 2014, Paneli ka shqyrtuar 35 lëndë, ka komunikuar 13 lëndë tek shefi i Misionit me kërkesa për vërejtje mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e tyre dhe ka marrë 29 vendime (përfshirë një vendim rreth pranueshmërisë së ankesave, e cila nuk i kanë dhënë fund shqyrtimit të asaj lëndë).

Për ndryshim nga vitet e mëparshme, Paneli ka konstatuar shkelje të të drejtave të njeriut në vetëm dy lëndë. Në të dyja këto vendime, Paneli ka gjetur shkelje të nenit 13 të KEDNj-së.

Përpos kësaj, 22 lëndë janë shpallur të papranueshme.



Gjatë vitit 2014, në Panel janë regjistruar 42 lëndë të reja, ku në krahasim me vitin e kaluar kanë qenë 27. Që nga fillimi i tij, Paneli ka parë një rritje të ngadaltë, por të qëndrueshëm të numrit të lëndëve. Deri në fund të vitit 2014, në Panel janë parashtruar gjithsej 136 lëndë, nga të cilat 94 janë mbyllur me vendime përfundimtare.



4.2. Trendët

Shumica e shkeljeve të dyshuara thuhet se janë rezultat i dështimit të dyshuar të EULEX-it për të vepruar. Ankesat e tilla kanë të bëjnë posaçërisht me refuzimin e dyshuar të prokurorisë për të

filluar hetimet dhe/ose dështimin për të ngritur padi. Një numër lëndësh kanë të bëjnë me akuzat për procedura të tej zgjatura pranë gjykatave të Kosovës.

4.3. Subjekti i ankesave

Llojet më të shpeshta të shkeljeve të dyshuara të të drejtave të njeriut të shqyrtuara nga Paneli në vitin 2014 ishin si në vijim:

- Shkeljet e dyshuara të së drejtës për jetë dhe siguri (Neni 5 i KEDNj-së): lëndët [Predrag Blagic kundër EULEX-it](#), nr. 2012-23; [Nexhat Qubreli kundër EULEX-it](#), nr. 2014-01;
- Shkeljet e dyshuara të së drejtës për gjykim të drejtë, civile apo penale (Neni 6 i KEDNj-së): lëndët [J kundër EULEX-it](#) nr. 2013-04; [Gani Gashi kundër EULEX-it](#), nr. 2013-22; [Ismail Krapci kundër EULEX-it](#) nr. 2014-22; [Shaip Selmani kundër EULEX-it](#), nr. 2014-23;
- Shkeljet e dyshuara të së drejtës për gjykim të drejtë (Neni 6 i KEDNj-së) në lidhje me shkeljen e gëzimit paqësor të një pronësie (Neni 1 i Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së): lëndët [Gani Zeka kundër EULEX-it](#), nr. 2013-15; [V kundër EULEX-it](#) nr. 2013-23; [Rifat Kadribasic kundër EULEX-it](#), nr. 2014-09;
- Shkeljet e dyshuara të së drejtës së lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë (Neni 9 i KEDNj-së): [Mirko Krlic kundër EULEX-it](#), nr. 2012-21;
- Shkeljet e dyshuara të së drejtës për zgjidhje efektive (Neni 13 i KEDNj-së) në lidhje me:
 - Nenin 8 (e drejta për privaci dhe jetë familjare): [Valbone Zahiti kundër EULEX-it](#), nr. 2012-14
 - Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së (e drejta në pronë): [Goran Becic kundër EULEX-it](#), nr. 2013-03;
- Shkeljet e dyshuara të së drejtës për gëzim paqësor të pasurisë (Neni 1 i Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së): [Vukovic kundër EULEX-it](#), nr. 2013-18; [Selatin Fazliu kundër EULEX-it](#), nr. 2014-28.

Një numër i ankuesve ju kanë drejtuar në mënyrë të përgjithësuar disa instrumenteve të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në veçanti Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut apo Konventës Ndërkombëtare për të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

5. Jurisprudenca

5.1. Meritat

Gjatë këtij viti raportues, janë konstatuar dy shkelje të të drejtave të njeriut nga EULEX-i. Në njëerën lëndë, në të cilën janë shqyrtuar meritat, nuk është gjetur ndonjë shkelje.

- 5.1.1. [Zahiti kundër EULEX-it](#) – obligimi i EULEX-it për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe për të siguruar një zgjidhje efektive juridike në rast të shkeljeve të pretenduara

Më 4 shkurt 2014, Paneli ka vendosur me shumicë se EULEX-i Kosovë kishte shkelur Nenin 13 të KEDNj-së, d.m.th. të drejtën për zgjidhje efektive juridike në lëndën nr. 2012-14, *Valbone Zahiti kundër EULEX-it*. Megjithatë, Paneli ka gjetur se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të KEDNj-së (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare).

Në atë lëndë, ankuesja ka pretenduar se gjatë kryerjes së detyrës së saj zyrtare, si zyrtare policore e Policisë së Kosovës, ajo ishte lënduar nga një zyrtar i EULEX-it (një zyrtar policor ndërkombëtar), i cili qëllimisht kishte vozitur veturën e tij në drejtim të saj. Si rezultat, ajo ishte lënduar dhe nuk ishte në gjendje të punonte për disa muaj. Njësia e EULEX-it për Hetime të Brendshme kishte nisur një hetim të brendshëm rreth incidentit. Më pas, rasti ishte mbyllur nga ShM, duke pasur parasysh vendimin e autoriteteve shtetërore për ta riatdhësuar pjesëtarin në fjalë. Prokurori Publik Komunal i Prishtinës ka kërkuar heqjen e imunitetit të zyrtarit të EULEX-it në fjalë. Në përgjigje, ShM ka ftuar prokurorin që të kontaktonte autoritetet shtetërore të pjesëtarit në fjalë përmes kanaleve zyrtare për të vendosur nëse ndonjë hetim ishte duke vazhduar në shtetin e tij. Derisa ishte qartësuar kjo pikë, ShM ka treguar se ai nuk do të jetë në gjendje të marrë ndonjë veprim të mëtejshëm në lidhje me heqjen e imunitetit.

Paneli së pari ka përsëriti se ishte obligim i EULEX-it në kuadër të Veprimit të Përbashkët të Këshillit për të siguruar që aktivitetet e veta duhet të kryhen në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Fakti se EULEX-i ka ushtruar kompetenca të caktuara ekzekutive, ka bartur mundësinë që ushtrimi i kompetencave të tilla mund të rezultojë në shkeljen e të drejtave të njeriut. Nga ana tjetër, kjo ka ngritur çështjen e disponueshmërisë së një zgjidhje të përshtatshëm për ta korrigjuar një shkelje të tillë, ku pretendimi i viktimës ishte "i bazueshëm". Paneli ka theksuar se nuk ishte në dyshim se ankuesja ishte fizikisht e sulmuar dhe lënduar nga një zyrtar policor i EULEX-it. Paneli ka konsideruar se ankesa e saj ka përbërë pretendim të bazuar.

Në anën tjetër, Paneli ka shqyrtuar mjete të ndryshme të mundshme që EULEX-i kishte argumentuar se ankuesja i kishte pasur në dispozicion të saj.

Paneli ka hedhur poshtë si të pabazë parashtresën e EULEX-it se vetë Paneli kishte ofruar një zgjidhje të mjaftueshëm. Paneli ka theksuar se EULEX-i mban përgjegjësinë e vet për të siguruar një zgjedhje efektive juridike për shkeljet e të drejtave që i ngarkohen misionit. Vënia e vetë përgjegjësisë së EULEX-it për të siguruar një zgjidhje të tillë juridike në Panel, do të ishte në kundërshtim me mandatin dhe obligimin e EULEX-it për të përmbushur detyrimin e vet për të drejtat e njeriut në përmbushjen e mandatit të tij ekzekutiv.

Paneli gjithashtu ka hedhur poshtë një argument se ankuesja duhej të kishte kërkuar kompensim qoftë nga EULEX-i apo drejtpërdrejtë nga zyrtari në fjalë. Paneli ka vënë në dukje se EULEX-i gjatë gjithë parashtrimeve të veta kishte marrë qëndrimin se nuk ishte përgjegjës për dëmin e shkaktuar ndaj ankuses, kështu që një kërkesë ndaj EULEX-it për t'i dhënë kompensim në lidhje me një veprim për të cilin Misioni e mohon se është përgjegjës, nuk do të mund të konsiderohej si zgjidhje efektive që ankuesja duhej të pritej që ta ndiqte. Megjithatë, Paneli ka vënë në dukje se ShM mund të kishte zgjedhur ex gratia (si obligim moral) të ofronte një formë të kompensimit ndaj ankuses. Paneli ka përsëritur se nuk ishte i autorizuar të rekomandojë kompensim me para.

Në lidhje me mundësinë e ankuses për të kërkuar të marrë kompensim përmes procedurave të ankesave ndaj palës së tretë, Paneli ka vënë në dukje se asnjëherë Misioni nuk i ka ofruar ndonjë kompensim ankuses sipas kësaj skeme.

Paneli ka konstatuar të panevojshme që të marrë ndonjë pozicion, në rrethanat e çështjes në fjalë, lidhur me atë nëse hetimet e brendshme të EULEX-it mund të thuhet se përbëjnë një "zgjidhje

efektive" atëherë kur pretendimi i shkeljes së të drejtave të njeriut është në rrezik. Paneli ka vënë në dukje vetëm se regjimi nuk ishte "i pavarur" nga EULEX-it, se nuk ishte treguar se mund të çojë drejtpërdrejtë në dhënien e kompensimit viktimës, se ai nuk mund të merr vendime të detyrueshme dhe se e ka lënë vendimin përfundimtar në zbatimin e një mase disiplinore në diskrecion të shefit të Misionit. Për më tepër, ankueses nuk iu është dhënë mundësia të merr pjesë në hetimin e brendshëm në asnjë rol procedural.

Çfarëdo zgjidhje që mund t'i lihet ankueses (që të dërgohej lënda e saj jashtë Kosovës tek autoritetet kompetente shtetërore të pjesëtarit të EULEX-it në fjalë) sipas mendimit të Panelit do të ishte qartasi shumë e vështirë dhe jo e sigurtë që të karakterizohet "efektive" në ato rrethana. Për më tepër, nuk mund të thuhet se do të ofronte ndonjë zgjidhje efektive kur është fjala për veprimet dhe përgjegjësinë e vet EULEX-it, pasi që kjo do të binte vetëm brenda juridiksionit dhe kompetencave të autoriteteve shtetërore.

Paneli ka konkluduar se EULEX-i kishte shkelur të drejtën e ankuesit për zgjidhje efektive, ku iu ishte mundësuar asaj të kërkoj dëmshpërblim për dëmin që i ishte shkaktuar nga një pjesëtar i EULEX-it.

Në lidhje me një shkelje të pretenduar të nenit 8 të KEDNj-së, Paneli ka konstatuar se veprimet e pjesëtarit të EULEX-it nuk mund të thuhet se përbëjnë shkelje të nenit 8 që i atribuohen Misionit. Rrjedhimisht, Paneli ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të KEDNj-së.

Paneli gjithashtu ka rekomanduar që të zbatohet një numër masash korrigjuese nga shefi i Misionit, për ta trajtuar çështjen në fjalë.

Vendimi pasues lidhur me rekomandimet e Panelit

Në vendimin pasues të Panelit të miratuar më 11 nëntor 2014, Paneli ka konstatuar se shefi i Misionit të EULEX-it kishte zbatuar disa nga rekomandimet e Panelit, por nuk kishte arritur t'i zbatojë të tjerat. Posaçërisht është vënë në dukje se shefi i Misionit nuk kishte zbatuar rekomandimin e Panelit që ai duhej ta pranonte shkeljen e të drejtave të ankueses nga ana e Misionit dhe nuk kishte hequr imunitetin e pjesëtarit të EULEX-it, ashtu siç ishte rekomanduar. Rrjedhimisht, Paneli ka ftuar shefin e Misionit ta rishikojë zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe e ka mbyllur shqyrtimin e kësaj lënde.

5.1.2. *Goran Becic kundër EULEX-it* – obligimi i EULEX-it për të regjistruar dhe për të shqyrtuar ankesat që përfshijnë akuzat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut

Në lëndën *Goran Becic kundër EULEX-it*, Paneli ka shqyrtuar shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut në lidhje me nenet 13 (e drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) i KEDNj-së, si dhe Nenin 1 i Protokollit 1 të KEDNj-së (e drejta për gëzimin paqësor të pronësisë).

Më 1 korrik 2014, Paneli ka *shpallur ankesën të pranueshme* dhe ka gjetur se ajo ka ngritur çështje serioze të fakteve dhe ligjit në lidhje me shkeljet e pohuara të neneve 13, 14 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së. Më 12 nëntor, Paneli ka marrë vendimin rreth meritave të kësaj lënde.

Ankuesi ka parashtruar se kishte në pronësi një banesë në Prishtinë. Pavarësisht një vendimi përfundimtar gjyqësor që vërtetonte pronësinë e tij mbi banesën, ai nuk pati sukses ta rimerrte zotërimin e saj dhe në disa raste individë të ndryshëm në mënyrë të paligjshme e kishin uzurpuar atë pas braktisjes së pronës nga persona të tjera. Ankuesi ka ngritur padi penale ndaj disa uzurpatorëve në Zyrën e Prokurorisë Publike Komunale në Prishtinë.

Ankuesi gjithashtu ka informuar EULEX-in përmes postës elektronike në lidhje me rastin e tij në nëntor të vitit 2009 dhe më pas ishte informua se ankesa e tij ishte dërguar në disa njësi në kuadër të Misionit të EULEX-it. Megjithatë, ankesa e tij nuk ishte regjistruar nga EULEX-i. Janë dashur dy vjet e nëntë muaj pas kontaktit të parë të ankuesit me EULEX-in që prokurorët e EULEX-it të njoftohen me rastin. Ndërsa në kohën kur Paneli ishte duke marrë vendimin lidhur me këtë çështje, asnjë hap nuk ishte ndërmarrë për të mbledhur informacionin e nevojshëm në lidhje me rastin në mënyrë që të merrej vendim për të.

Gjatë shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli së pari ka theksuar se nuk ishte detyrë e tij të vlerësoj meritat e një vendimi të prokurorisë se a të fillojë hetimet ose të marrë përsipër hetimin nga autoritetet e Kosovës. Megjithatë, ishte e një rëndësie të madhe se pretendimet e bazuara që parashtrihen në EULEX-it nga individë duhet të regjistrohen me kohë për të bërë një vlerësim informues se a do ta hetojnë rastin apo jo. Duhet që në mënyrë të arsyeshme të pritët nga një Mision me mandat ekzekutiv që të zbatohet një sistem i efektshëm i regjistrimit dhe komunikimit të ankesave me qëllim që të sigurohen se ato regjistrohen, shënohen siç duhet dhe gjithashtu shqyrtohen. Paneli ka konkluduar se në këtë rast kjo nuk kishte ndodhur.

Paneli ka konsideruar se EULEX-i nuk kishte arritur të zbatojë një sistem të besueshëm të regjistrimit dhe shënimit të ankesave që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave, të cilat kanë rezultuar që rasti i ankuesit të mbetet i pazgjidhur për një periudhë prej rreth dy vjet e nëntë muaj. Gjatë kësaj periudhe, EULEX-i nuk kishte treguar kujdes në përmbushjen e mandatit të tij në lidhje me atë ankesë. Fakti se autoritetet e Kosovës ishin *gjithashtu* kompetente në lidhje me këtë çështje, sipas mendimit të Panelit nuk e liron EULEX-in nga obligimet e veta për të vepruar në çdo kohë në një mënyrë që është në përputhje me standardet minimale të të drejtave të njeriut.

Rrjedhimisht, Paneli ka konkluduar se kishte pasur shkelje të të drejtave të ankuesit sipas nenit 13 të KEDNj-së. Më tej, Paneli ka konsideruar se nuk ishte e nevojshme të shqyrtohet ankesa sipas nenit 14 të KEDNj-së dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së.

Paneli ka bërë rekomandim që të zbatohen masa korigjuese nga shefi i Misionit për ta adresuar shkeljen.

5.1.3. [Mirko Krlic kundër EULEX-it](#) – Obligimet pozitive të EULEX-it për ta mbrojtur të drejtën e ankuesit që t'i respektohet jeta e tij private

Ankuesit, zyrtar i qeverisë serbe, iu ishte refuzuar hyrja në Kosovë nga ana e Policisë Kufitare të EULEX-it. Formulari standard për refuzimin e hyrjes që iu ishte lëshuar atij në atë rast shkruante se si zyrtar nga Serbia, atij i ishte kërkuar të bënte një kërkesë zyrtare tek autoritetet e Kosovës para se ai të hynte. Ankuesi ka pretenduar se vizita e tij që kishte synim ishte e karakterit privat. Ai ka parashtruar se duke ia mohuar atij hyrjen në Kosovë dhe pjesëmarrjen në festimet fetare, EULEX-i kishte shkelur nenin 9 (liria e fesë) dhe nenin 2 të Protokollit nr. 4 (liria e lëvizjes) të KEDNj-së.

Paneli ka vendosur të shqyrtojë lëndën po ashtu edhe në bazë të nenit 8 të KEDNj-së (e drejta për respektimin e jetës private). Paneli ka përsëritur se në bazë të jurisprudencës së zhvilluar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nocioni i “jetës private” në kuptim të kësaj dispozite ishte një koncept i gjerë që *ndër të tjera* përfshinte të drejtën për të vendosur dhe zhvilluar marrëdhënie me njerëz të tjerë. Prandaj kjo dispozitë ishte e zbatueshme për rrethanat e lëndës.

Më tej, Paneli ka përsëritur se edhe pse subjekti i nenit 8 në thelb ishte mbrojtja e një individi ndaj ndërhyrjes arbitrare nga autoritetet publike, mund të ketë obligime pozitive të pandashme në

respektimin efektiv të jetës private. Kufijtë midis obligimeve pozitive dhe negative të autoriteteve, sipas nenit 8 nuk japin definicion të saktë, mirëpo parimet e zbatueshme megjithatë kanë qenë të ngjashme. Në veçanti, në të dy rastet, ka pasur ekuilibër të drejtë që duhej të arrihej midis interesit të përgjithshëm dhe interesave individuale; dhe në të dy kontekstet autoritetet kanë gëzuar liri të caktuar për të bërë vlerësimin.

Paneli ka vazhduar të shqyrtojë nëse është dashur që EULEX-i në kontekstin e obligimeve të saj pozitive sipas nenit 8, të mbrojë të drejtën e ankuesit që t'i respektohej jeta e tij private duke i lejuar atij të hynte në Kosovë. Paneli ka konstatuar se ankuesi nuk ka respektuar kërkesat procedurale në fuqi. Sipas mendimit të Panelit, ankuesi nuk ka parashtruar argumente bindëse se ai nuk kishte mundur të ishte në dijeni rreth procedurës së përcaktuar apo se ishte e paarsyeshme për ato rrethana që të pritej nga ai ta zbatonte atë.

Sipas kësaj çfarë u paraqit më lartë, Paneli ka konkluduar se Policia Kufitare e EULEX-it ka vepruar brenda vlerësimit të saj, se ka ekzistuar një ekuilibër i drejtë midis interesave konkurruese në rastin në fjalë dhe rrjedhimisht refuzimi për t'ia lejuar hyrjen ankuesit në Kosovë ishte i arsyeshëm dhe proporcional në rrethanat e rastit. Prandaj, Paneli ka gjetur se nuk ka pasur shkelje të Nenit 8 të Konventës.

Duke pasur parasysh gjetjet në bazë të nenit 8, Paneli ka konsideruar të panevojshme të shqyrtohet ankesa në bazë të nenit 9 dhe nenit 2 të Protokollit nr. 4 të Konventës veç e veç.

5.2. Pranueshmëria

Në disa vendime, Paneli ka adresuar çështje të ndryshme të rëndësishme lidhur me pranueshmërinë e ankesave të parashtruara aty:

5.2.1. Kompetenca e Panelit për shqyrtimin e procedurave të gjykatave në Kosovë

Në një numër vendimesh (p.sh. lëndët nr. 2013-24 [Maxhuni kundër EULEX-it](#), 2013-22 [Gashi kundër EULEX-it](#), 2013-15 [Zeka kundër EULEX-it](#); 2013-04 [J kundër EULEX-it](#)), Paneli ka përsëritur qëndrimin e tij se në bazë të Rregullës 25, paragrafi 1 i Rregullores së Punës, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk ka juridiksion sa i përket aspekteve administrative apo gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës (shih 2.2 më lartë). Fakti që gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues nuk e ndryshon karakterin e këtyre gjykatave si gjykata të Kosovës.

Në anën tjetër, Paneli ka mbështetur pikëpamjen e vet se veprimet e prokurorëve të EULEX-it të ndërmarra në kuadër të hetimit penal kanë qenë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe për këtë arsye kanë hyrë në kuadër të mandatit të Panelit. Veprimet apo mos veprimet nga prokurorët e EULEX-it gjatë fazës hetimore të procedurës penale nuk duhet të konsiderohen si pjesë përbërëse e “procedurave gjyqësore” për qëllimet e përcaktimit të kompetencës së Panelit. Pra veprimet e tyre i nënshtrohen autoritetit të Panelit, atëherë kur pretendohet se kanë pasur shkelje të të drejtave të njeriut (p.sh. shih lëndët [Becic kundër EULEX-it \(vendim mbi pranueshmëri\)](#), nr. 2013-03; [B.Y. kundër EULEX-it](#), nr.2014-06).

Për më tepër, Paneli ka vënë në dukje se nuk mund të përjashtohet që Paneli mund të ketë kompetencë të vlerësoj veprimet e prokurorëve të EULEX-it në hetimet penale edhe nëse ato i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, nëse ngrehin çështje të të drejtave të njeriut, apo nëse nuk janë

adresuar plotësisht nga autoritetet kompetente gjyqësore (p.sh. lënda [Tomë Krasniqi kundër EULEX-it](#), nr. 2014-04).

5.2.2. Ri-shqyrtimi i një ankese

Në vitin 2014, Paneli ka shqyrtuar tri kërkesa për rishqyrtimin e vendimeve të papranueshme (lëndët [Shaban Kadriu kundër EULEX-it](#), nr.2013-27; [Tomë Krasniqi kundër EULEX-it](#), nr. 2014-04; [J kundër EULEX-it](#), nr. 2013-04). Në të tria këto lëndë, ishte argumentuar se në vendimin fillestar, Paneli nuk kishte arritur të merrte parasysh dëshmi të caktuar të dokumentuara.

Paneli ka pranuar të rishqyrtonte këto lëndë, mirëpo i ka vërtetuar vendimet e veta fillestare. Është konsideruar se procedura e ri-shqyrtimit e parashikuar në rregullën 42 kishte për qëllim të ofrojë një mekanizëm procedural përmes së cilit parashtruesi i ankesës mund të kërkojë rishqyrtimin e një vendimi të papranueshmërinë, aty ku një fakt i ri që ai nuk ka mundur ta dijë në kohën e ankesës fillestare do të kishte pasur ndikim vendimtar në konstatimet e Panelit.

Në atë rast, ankuesi nuk kishte arritur të tregojnë ndonjë fakt të ri që lidhej me zbatimin e rregullës 42 dhe nuk kishte mundur të vërtetojë se si dokumentet e reja do të kishin ndikim vendimtar në gjetjet e bëra nga Paneli në vendimin e tij të papranueshmërisë.

5.3. Vendimet pasuese

Përveç vendimit në lëndën [Zahitit kundër EULEX-it](#) të diskutuara më lartë, Paneli ka marrë edhe tre vendime pasuese.

Të ashtuquajturat "rastet e Vidovdanit" ([A, B, C dhe D](#), nos 2012-09, 2012-10, 2012-11 dhe 2012-12; [H dhe G](#), nos. 2012-19 dhe 2012-20) kishin të bënin me incidentet që kishin ndodhur në Vidovdan më 28 qershor 2012. Festa e Vidovdan shënon një festë të rëndësishme fetare, ku mijëra serbë etnikë vizitojnë objekte përkujtimore në Kosovë, ku vendi kryesor është Gazimestani, vendi i monumentit që përkujton betejën e Kosovës të vitit 1389. Të katër ankuesit kishin parashtruar se ju ishin nënshtruar sulmeve nga persona privat dhe ishin sulmuar nga Policia e Kosovës dhe ju ishin konfiskuar gjësendet e tyre. Paneli ka konstatuar se shefi i Misionit kishte ushtruar funksionet e tij me zell dhe në mënyrë efektive në zbatimin e rekomandimeve të Panelit dhe ka vendosur ta mbyll shqyrtimin e rasteve. Në vendimin lidhur me lëndët [H dhe G](#), Paneli ka ftuar shefin e Misionit të rishqyrtojë qëndrimin e tij në lidhje me mundësinë e pranimit të shkeljeve të të drejtave të ankuesve.

Vendimi pasues në lëndën [W kundër EULEX-it](#) (nr. 2011-07) ishte vendimi pasues i dytë në lidhje me këtë rast të veçantë. Ankuesi ka pretenduar se prokurorët e EULEX-it Kosovë kishin shpërndarë deklaratën e tij prej dëshmitari dhe të dhënat e tij personale tek autoritetet shtetërore të Serbisë në lidhje me një hetim për krime lufte. Në vendimin e tij të parë pasues të datës 26 nëntor 2013, Paneli e kishte përgëzuar ShM për zbatimin e shumicës së rekomandimeve të tij. Gjithashtu është vënë në dukje se një numër i rekomandimeve të tij kishin ende për t'u zbatuar. Prandaj, Paneli ka ftuar ShM t'i zbatoj ato. Pas shqyrtimit të parashtrësive të mëvonshme të ShM, Paneli ka konstatuar se Misioni kishte zbatuar shumicën e rekomandimeve të Panelit dhe ka konstatuar faktin se shefi i Misionit kishte zgjedhur që mos ta zbatonte njërin prej tyre. Rrjedhimisht, Paneli ka vendosur ta mbyllë shqyrtimin e kësaj lënde.

6. Aktivitetet e Panelit

6.1. Fushata informuese e vitit 2014

Dokumenti i Konceptit të Llogaridhënies i datës 29 tetor 2009 ndër të tjera pohon në paragrafin E, se "... EULEX-i në Kosovë do të siguroj shpërndarje të duhur të informacionit publik rreth Panelit dhe punës së tij ...".

Komandanti i Operacioneve Civile ka deklaruar në paragrafin 3 të Udhëzimit të tij të datës 13 nëntor 2009 në lidhje me Panelin se "Udhërrëfyesi" për Planifikim Civil dhe Mundësi Operacionale duhet të përfshijnë, ndër të tjera "përgatitjen e një fushate gjithëpërfshirëse të marrëdhënies me publikun".

Prandaj, Paneli siç përshkruhet më herët në këtë raport ka qenë i angazhuar në kryerjen e një fushate të gjerë në terren për t'i informuar qytetarët rreth Panelit që nga qershori i vitit 2010. Fushata ka qenë mjaft efikase në ngritjen e informimit rreth Panelit, veçanërisht në zonat urbane ku EULEX-i ka një paraqitje më të madhe, duke gjykuar nga një rritje e qëndrueshme e numrit të ankesave të regjistruara.

Paneli dhe Sekretariati kanë vazhduar me kryerjen e fushatës informuese në terren gjatë vitit 2014. Fushata më së shumti është përqendruar në gjyqësorin e Kosovës, OJQ-të, përfaqësuesit e shoqërisë civile, si dhe në organe të tjera fetare. Paneli gjithashtu është angazhuar në intervista në media, ndërsa Sekretariati ka marrë pjesë në konferenca, seminare dhe debate të ndryshme lidhur me të drejtat e njeriut. Sekretariati dhe anëtarët e Paneli kanë po ashtu kanë zhvilluar aktivitetet rreth fushatës informuese në veri të Mitrovicës pasi gjendja e sigurisë ka lejuar një gjë të tillë.

Formati i takimeve gjatë fushatës informuese zakonisht ka përfshirë një prezantim të shkurtër rreth mandatit, procedurave, funksioneve dhe punëve të Panelit, si dhe një informacion të shkurtër rreth ligjit në fuqi sipas të cilit funksion Paneli. Ka pasur edhe mundësi për pyetje dhe përgjigje si dhe diskutim dhe debat atëherë kur ka qenë e përshtatshme. Janë shpërndarë po ashtu edhe materiale informuese të Panelit si fletëpalosje dhe postera në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

Në vitin 2014, Paneli ka vazhduar me takimet e veta të kohëpaskohshme me shefin e Misionit, zëvendës shefin e Misionit dhe zyrtarë të tjerë të lartë të EULEX-it.

Transmetimi i një reklame televizive në vitin 2014 i ka ndihmuar shumë Panelit që të komunikoj me popullatën urbane dhe rurale, posaçërisht me rajonet më të thella të Kosovës. Një spot i shkurtër televiziv ku shpjegohet roli i Panelit dhe ku ofrohet informacion mbi procedurën e ankesës është filmuar dhe redaktuar nga zyra për shtyp dhe informim publik e EULEX-it. Pastaj është transmetuar nga kanalet informative kryesore të Kosovës (kanalet në gjuhën shqipe dhe serbe) në janar dhe shtator. Pas transmetimit të parë është vërejtur se Paneli ka pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave të reja, ku disa nga parashtruesit e ankesave kanë treguar se kanë mësuar për ekzistencën e Panelit nga televizioni.

Është parë shumë se vazhdimi i fushatës televizive gjatë vitit 2015 (dhe me gjasë edhe shtrirja e saj në radio stacione) mund të rrisë edhe më tej informimin rreth ekzistencës dhe rolit të Panelit.

6.2. Trajnimi hyrës për personelin e EULEX-it

Sekretariati ka marrë pjesë në programin e trajnimit hyrës të EULEX-it për pjesëtarët e rinj të personelit të EULEX-it. Formatu përbëhet nga një prezantim që bëhet nga Paneli me një kohë të caktuar për pyetje dhe përgjigje. Ky është një forum shumë i dobishëm për të informuar personelin e

ri rreth mandatit të Panelit dhe për të rritur paraqitjen e Panelit tek personeli i EULEX-it në zonën e misionit.

Kjo është konsideruar të jetë veçanërisht e rëndësishëm për shkak se i ofron Panelit një mundësi që të informojë personelin e EULEX-it në Divizionin Ekzekutiv rreth implikimeve në llogaridhënie sa i përket shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre ekzekutive. Paneli e konsideron këtë një mundësi të rëndësishme për të siguruar se i gjithë personeli që vjen për herë të parë është i vetëdijshëm për obligimin e tyre për të përmbushur standardet përkatëse të të drejtave të njeriut në kryerjen e funksionit të tyre.

6.3. Faqja e internetit e PShDNj-së

Sekretariati është përgjegjës për rregullimin dhe mirëmbajtjen e faqes së internetit të Panelit: www.hrrp.eu. Kjo faqe përmban informata të dobishme rreth mandatit, funksioneve, veprimtarive dhe punës së Panelit, si dhe komunikatave për shtyp, statusin e tanishëm të lëndëve në pritje dhe lëndëve të përfunduar, përfshirë këtu të gjitha vendimet e marra nga Paneli. Sekretariati vazhdimisht përpiqet edhe që më tutje të zhvilloj dhe përmirësoj faqen e internetit.

Aty gjithashtu ka informata rreth standardeve të zbatueshme të të drejtave të njeriut si dhe formular të aplikacioneve dhe udhëzimeve për plotësimin e ankesave në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

Lëndët e Panelit janë të organizuara në mënyrë që palët e interesuara mund të kenë qasje të lehtë dhe po ashtu aty mund të kërkohet lehtë. Kjo tabelë mundëson që jurisprudenca e Panelit gjithnjë e në rritje të kërkohet përmes subjektit të lëndës (edhe rreth pranueshmërisë dhe përmbajtjes) dhe ajo është krijuar për të siguruar qasje të gatshme në jurisprudencën e Panelit, edhe për ankues dhe për avokatë.

Në vitin 2014, faqja e Panelit është vizituar rreth 5.000 herë prej më shumë se 3600 përdoruesve.

Në vitin 2014, Paneli gjithashtu ka krijuar profilin e vet në Facebook, duke ofruar informata rreth aktiviteteve dhe jurisprudencës së vet. Faqja është “pëlqyer” prej rreth 430 përdoruesve të Facebook-it deri më tani.

7. Çështjet operative/administrative

7.1. Papranueshmëria e ankesave

Si në vitin paraprak, Paneli ka konstatuar se një përqindje e lartë e ankesave është shpallur e papranueshme. Këto ankesa ndër të tjera përmbajnë mangësitë e shënuara në vijim: ankesat kanë qenë haptas të pabazuara në kuptimin se ato nuk kanë parashtruar dëshmi prima facie rreth shkeljeve të të drejtave të njeriut; ato kanë dalë jashtë mandatit ekzekutiv të EULEX-it dhe për pasojë kanë qenë jashtë juridiksionit të Panelit; ankesat nuk ishin në përputhje racione temporis me Rregulloren e Punës, pasi ato kanë përmendur ngjarjet që kishin ndodhur para themelimit të Panelit, ose janë parashtruar pas skadimit të afatit kohor të përcaktuar në Rregulloren e Punës të Panelit (shih Rregullën 25 paragrafin 3).

Ankuesit përfaqësohen rrallë nga avokatë, edhe pse numri i rasteve të paraqitura nga përfaqësues ligjorë ishte më e lartë se në vitet e mëparshme. Po ashtu duket se ankuesit shpeshherë e konsiderojnë Panelin si organ të fundit, atëherë kur shteren të gjitha mjetet e tjera të mundshme

pranë autoriteteve të Kosovës. Mos ekzistimi i një mundësie procedurale për të sjellë një ankesë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, gjithashtu mund të shpjegon që ankuesit vijnë në Panel nën supozimin e gabuar se kompetenca e Panelit ka karakter të ngjashëm.

Gjatë fushatës informuese në vitin 2015, Paneli do të kërkoj t'ju qaset këtyre çështjeve dhe mangësive me një theks të veçantë në ofrimin e informatave lidhur me kriteret për pranueshmërinë e ankesave.

7.2. Buxheti

Deri në 2014, Paneli nuk ka pasur buxhet të dedikuar në mënyrë specifike dhe në këtë drejtim ishte krejtësisht i varur nga sistemin buxhetor i EULEX-it.

Megjithatë, në vitin e fundit është ndarë për Panelin një buxhet i veçantë për fushatën informuese në terren dhe për materialet promovuese. Ky është një hap i mirëpritur që i mundëson Panelit të marrë vendimet e veta në zgjerimin e fushatës informuese në terren, në veçanti në transmetime në TV ose radio, pa iu drejtuar burimeve të EULEX-it Kosovë.

Dhënia buxhetore shtesë në masë të madhe do të ndihmonte Panelin në punën e tij të përditshme. Kjo do të rrisë më tej pavarësinë e vërtetë dhe të perceptuar të Panelit dhe në këtë mënyrë rritë edhe më tej besueshmërinë e Misionit të EULEX-it lidhur me të drejtat e njeriut.

Megjithatë, duhet të theksohet se përndryshe Paneli është i kënaqur me mbështetjen e dhënë nga EULEX-i dhe vlerëson ndihmën e përgjithshme administrative dhe financiare që ka marrë deri më tani nga Misioni.

8. Vërejtjet përfundimtare

Si në vitet e mëparshme, Paneli rekomandon që synimi për informim më të madh rreth të drejtave të njeriut në gjithë Misionin e EULEX-it duhet që të vazhdon të ndiqen në mënyrë aktive. Në këtë kontekst, Paneli rekomandon që BE-ja dhe EULEX-i të sigurojnë që mbrojtja efektive e të drejtave të njeriut në Kosovë të jetë dhe të mbetet çështje e rëndësishme në trajnimin e pjesëtarëve të rinj të EULEX-it.

Një trajnim i tillë mund të zgjerohet gjithashtu në divizionet dhe njësitë përkatëse të EULEX-it për të siguruar një njohuri të përbashkët të obligimeve rreth të drejtave të njeriut të EULEX-it nga personeli i EULEX-it. Pjesëtarët e EULEX-it kanë prejardhje të ndryshme kombëtare dhe profesionale. Ata kanë nivele të ndryshme të edukimit rreth të drejtave të njeriut, kështu të drejtat e njeriut kanë pasur nivele të ndryshme të rëndësisë në shtetet prej nga vijnë. Kjo do të mund të adresohen në mënyrë efektive duke siguruar që të ketë standarde të njëjta për të gjithë pjesëtarët e Misionit.

Paneli gjithashtu rekomandon që EULEX-i duhet t'i përdor të gjitha mekanizmat e nevojshëm në kuadër të Misionit dhe të caktoj burime të mjaftueshme për t'u marrë me shpejtësi dhe në mënyrë efektive me kërkesat e Panelit për informata që kanë të bëjnë me ankesat e parashtruara në Panel. Deri më tani, në shumicën lëndëve të komunikuar është kërkuar nga Misioni zgjatja e afatit, duke shkaktuar vonesa në shqyrtimin dhe zgjidhjen e lëndëve. Burime

shtesë për organet kompetente të Misionit do t'i mundësonte Misionit ta kryen këtë funksion në mënyrë më të shpejtë dhe më efikase.

Paneli rekomandon që BE-ja dhe EULEX-i duhet të sigurojnë që angazhimi i shteteve anëtare të BE-së dhe si rrjedhojë angazhimi i vet për të mbrojtur standardet e pranuar të të drejtave të njeriut në Kosovë duhet të mbetet real, konkret dhe efektiv. Prandaj, Paneli rekomandon që EULEX-i Kosovë duhet të vazhdojë të jetë e angazhuar plotësisht në promovimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në gjithë sferën e aktiviteteve të ndërmarra nga EULEX-i.

Në veçanti, Paneli konsideron se është thelbësore që Misioni duhet të veprojë me kujdesin më të madh dhe me transparencë të duhur kur ka të bëjë me pohimet për sjellje jo të mira dhe parregullsi në kuadër të Misionit. Rrënimi i legjitimitetit dhe besueshmërisë së Misionit që do të rezultonte nëse nuk veprohet në atë mënyrë, do të ndikonte negativisht në kontributin e tij - dhe në kontributin e Panelit për ndërtimin e një kulture të respektimit të sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut në Kosovë.

Në këtë kontekst, Paneli edhe njëherë nënvizon rëndësinë që shtetet duhet të japin për të siguruar se promovimi i të drejtave të njeriut duhet të mbeten prioritet në Kosovë edhe pasi Misioni të jetë zvogëluar dhe të ketë përfunduar.

SHTOJCA 1 Tabela e personelit

| Paneli | |
|--------------------------------|--|
| Magda Mierzewska | Kryesuese e Panelit |
| Guénaël Mettraux | Anëtar i Panelit |
| Katja Dominik | Anëtare e Panelit, gjykatëse e EULEX-it |
| Elka Filcheva-Ermenkova | Anëtare zëvendësuese e Panelit, gjykatëse e EULEX-it |

| Sekretariati | |
|----------------------------|---|
| John J. Ryan | Zyrtar i lartë ligjor nga muaji prill 2010 deri më dhjetor 2014 |
| Joanna Marszałik | Zyrtare ligjore |
| Florian Razesberger | Zyrtar ligjor nga muaji shtator 2012 deri në dhjetor 2014 |
| Shpresa Gosalci | Asistente administrative/gjuhësore (shqip-anglisht) |
| Katica Kovacevic | Inteprete/përkthyes (serbisht-anglisht) |
| Kushtrim Xhaferi | Interpret/përkthyes (shqip-anglisht) |

| | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | Total |
|---|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|------------|
| Lëndët e regjistruara - Gjithsej | 16 | 28 | 23 | 27 | 42 | 136 |
| Lëndët e përfunduara - Gjithsej | 6 | 30 | 10 | 20 | 28 | 94 |
| Të pranueshme | | | 2 | | 1 | 3 |
| Të papranueshme | 6 | 22 | 10 | 13 | 22 | 73 |
| Shkelje | 0 | 2 | 0 | 7 | 2 | 11 |
| Nuk ka shkelje | 0 | 5 | 0 | 0 | 1 | 6 |
| Të hequra në lista | 0 | 1 | 0 | 0 | 3 | 4 |

| | Më 31 dhjetor 2014 |
|--------------------------|---------------------------|
| Lëndët jo të përfunduara | 42 |
| Të komunikuar te ShM | 25 |

SHTOJCA 4
Vendimet e PShDNj-së 2010-2014

| | Lënda | Ankuesi | Subjekti | Rezultati |
|-----|---------|------------------------|--|----------------|
| 1. | 2010-01 | Djeljalj Kazagic | Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, çështje pronësore | Shkelje |
| 2. | 2010-02 | Sadik Thaqi | Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003 | Nuk ka shkelje |
| 3. | 2010-03 | Osman Mehmetaj | Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003 | Nuk ka shkelje |
| 4. | 2010-04 | Feti Demolli | Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003 | Nuk ka shkelje |
| 5. | 2010-05 | Mursel Hasani | Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003 | Nuk ka shkelje |
| 6. | 2010-06 | Latif Fanaj | Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës, 04/09/2003 | Nuk ka shkelje |
| 7. | 2010-07 | Blerim Rudi | Dyshohet në mos zbatim të urdhrit të lëshuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për rikthim në punë të ankuesit nga ana e Njësisë së Inteligjencës Financiare | Shkelje |
| 8. | 2010-08 | Delimir Krstic | Dyshohet në mos veprim nga policia dhe prokuroria e EULEX-it, çështje pronësore | E papranueshme |
| 9. | 2010-09 | Burim Ramadani | Dyshohet në mos-funksionim të sistemit gjyqësor, rasti Kiçina | E papranueshme |
| 10. | 2010-10 | Horst Proetel | Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë në EULEX | E papranueshme |
| 11. | 2010-11 | Laura Rudi | Ankesë private financiare ndaj një punëtori të EULEX-it | E papranueshme |
| 12. | 2010-12 | Hunaida Pasuli | Kandidaturë jo e suksesshme në një pozitë pune në EULEX | E papranueshme |
| 13. | 2010-13 | Një punëtor i EULEX-it | Kontest i brendshëm në EULEX lidhur me vlerësimin e punës dhe marrëdhëniet personale me mbikëqyrësin | E papranueshme |
| 14. | 2010-14 | Lulzim Gashi | Kandidim jo i suksesshme në një pozitë pune në EULEX | E papranueshme |

| | Lënda | Ankuesi | Subjekti | Rezultati |
|------------|----------------|----------------------------|--|------------------------------|
| 15. | 2010-15 | Faton Sefa | Mos rikthimi në vendin e mëparshëm të punës (sektor privat), dyshohet në mos zbatim të vendimit të gjykatës | E papranueshme |
| 16. | 2010-16 | Cyma Agovic | Transferuar nga EULEX-i – Mos shqyrtim i drejtë i lëndës së ankueses nga ana e gjykatësve të EULEX-it | E papranueshme |
| 17. | 2011-01 | Familja e Dedë Gecaj | Kërkesë për hetim të vendimit të gjykatave të EULEX-it në Kosovë për ekstradim në rastin e të ndjerit Dedë Gecaj | E papranueshme |
| 18. | 2011-02 | Chamalagai Krishna Bahadur | Dyshohet në mos veprim | E papranueshme |
| 19. | 2011-03 | Afrim Mustafa | Kontest në lidhje me një radio stacion privat dhe konfiskimi i pajisjeve të radio stacionit | E papranueshme |
| 20. | 2011-04 | Besim Berisha | Ankesë rreth kushteve të jetës në burgun e Dubravës | E hequr nga lista e ankesave |
| 21. | 2011-05 | SH.P.K "Syri" | Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, SCSC | E papranueshme |
| 22. | 2011-06 | Milazim Blakqori | Dyshohet në moszbatimin e një vendimi, mosveprim nga ana e EULEX-it | E papranueshme |
| 23. | 2011-07 | Lënda W | Dyshohet në shkeljen e nenit 6 të KEDNJ-së | Shkelje |
| 24. | 2011-08 | Anton Rruka | Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, SCSC | E papranueshme |
| 25. | 2011-09 | Mirkovic Bojan | Dyshohet në largim nga puna në mënyrë të paligjshme nga EULEX-i | E papranueshme |
| 26. | 2011-10 | Dejan Jovanovic | Dyshohet në vonesë të panevojshme gjatë procedurave në SCSC | E papranueshme |
| 27. | 2011-11 | Srecko Martinovic | Dyshohet në përdorim të tepruar të forcës, trajtim dhe mohim të së drejtës për gjykim të drejtë | E papranueshme |
| 28. | 2011-12 | Novica Trajkovic | Dyshohen në përdorim të tepruar të forcës | E papranueshme |
| 29. | 2011-13 | S.M. | Dyshohet në përdorim të tepruar të forcës, mohim të së drejtës për gjykim të drejtë dhe mos respektim të jetës private | E papranueshme |
| 30. | 2011-14 | Lindita Shabani | Dyshohet në mohim të së drejtës për jetë private dhe familjare | E papranueshm |

| | Lënda | Ankuesi | Subjekti | Rezultati |
|------------|----------------|-------------------|--|------------------|
| | | | | e |
| 31. | 2011-15 | Samedin Smajli | Dyshohet në mohim të gjyimit të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave | E papranueshme |
| 32. | 2011-16 | Avdyl Smajli | Dyshohet në mohim të gjyimit të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave | E papranueshme |
| 33. | 2011-17 | Faik Azemi | Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë | E papranueshme |
| 34. | 2011-18 | Mykereme Hoxha | Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it | E papranueshme |
| 35. | 2011-19 | Sefer Sharku | Dyshohet në mos respektim të një vendimi detyrues gjyqësor | E papranueshme |
| 36. | 2011-21 | Ventor Maznikolli | Dyshohet në vonesë të panevojshme nga gjykatësit e EULEX-it rreth caktimit të një seance në Gjykatën Supreme | E papranueshme |
| 37. | 2011-22 | Hysni Gashi | Dyshohet në mohim të një gjykimi të drejtë dhe dyshohet në paaftësi të gjykatësve të EULEX-it | E papranueshme |
| 38. | 2011-23 | Hashim Rexhepi | Dyshohet në shkelje të së drejtës për liri dhe të së drejtës për gjykim të drejtë. | E papranueshme |
| 39. | 2011-24 | Predrag Lazic | Dyshohet në mos caktimin e një gjykimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm | E papranueshme |
| 40. | 2011-25 | Shaip Gashi | Dyshohet në privim nga pensioni gjerman për persona me paaftësi | E papranueshme |
| 41. | 2011-26 | Njazi Asllani | Dyshohet në mos zbatim të një vendimi, mos veprim nga EULEX-i | E papranueshme |
| 42. | 2011-28 | Lënda Y | Dyshohet në shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare. | E papranueshme |
| 43. | 2012-01 | Qamil Hamiti | Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë | E papranueshme |
| 44. | 2012-02 | Arben Zeka | Dyshohet në mos gjykim të një lënde pronësore | E papranueshme |
| 45. | 2012-03 | Rexhep Dobruna | Dyshohet në mohim të së drejtës për gjykim të drejtë | E papranueshme |

| | Lënda | Ankuesi | Subjekti | Rezultati |
|------------|----------------|-------------------|--|------------------|
| 46. | 2012-04 | Izet Maxhera | Kontest pronësor me EULEX-in në Mitrovicë | E papranueshme |
| 47. | 2012-05 | Fatmir Pajaziti | Dyshohet në shkelje të së drejtës për liri dhe gjykim të drejtë | E papranueshme |
| 48. | 2012-06 | Lënda Z | Dyshohet në shkelje të nenit 10 dhe 11 të DUDNj-së, nenet 5 dhe 6 të KEDNj-së, nenit 9 të KDDCP-së dhe nenit 6 të KKT-së | E papranueshme |
| 49. | 2012-07 | Lënda I | Dyshohet në mosveprim nga ana e prokurorit të EULEX-it dhe policisë së EULEX-it | E papranueshme |
| 50. | 2012-08 | Lënda U | Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 51. | 2012-09 | Lënda A | Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së | Shkelje |
| 52. | 2012-10 | Lënda B | Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së | Shkelje |
| 53. | 2012-11 | Lënda C | Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së | Shkelje |
| 54. | 2012-12 | Lënda D | Dyshohet në shkelje të neneve 2, 3, 8, 9, 10 dhe 11 të KEDNj-së | Shkelje |
| 55. | 2012-13 | Bejtush Gashi | Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 56. | 2012-15 | Shefqet Emerllahu | Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, mos hetim | E papranueshme |
| 57. | 2012-16 | Kristian Kahrs | Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, mosveprim | E papranueshme |
| 58. | 2012-17 | Lënda E | Dyshohet në shkelje të nenet 5 dhe 6 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 59. | 2012-18 | Hamdi Sogojeva | Dyshohet në shkelje të nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 60. | 2012-19 | Lënda H | Dyshohet në konfiskim të pronës | Shkelje |
| 61. | 2012-20 | Lënda G | Dyshohet në shkelje të neneve 3, 10, 11 të KEDNj-së dhe nenit 1 të protokollit 1 të KEDNj-së | Shkelje |
| 62. | 2012-21 | Mirko Krlic | Dyshohet në shkelje të nenit 9 të KEDNj-së dhe nenit 2 të Protokollit 4 të KEDNj-së | Nuk ka shkelje |

| | Lënda | Ankuesi | Subjekti | Rezultati |
|------------|----------------|--------------------------------|--|------------------------------|
| 63. | 2012-23 | Predrag Blagic | Dyshohet në shkelje të nenit 5 të KEDNj-së dhe nenit 2 të protokollit 4 të KEDNj-së | E hequr nga lista e ankesave |
| 64. | 2013-01 | Lënda I | Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 65. | 2013-02 | Arsim Krasniqi | Dyshohet në shkelje të nenit 3 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 66. | 2013-03 | Goran Becic | Dyshohet në shkelje të nenit 5 dhe 14 të KEDNj-së dhe nenit 2 të protokollit 1 të KEDNj-së | Shkelje |
| 67. | 2013-04 | J | Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 68. | 2013-15 | Gani Zeka | Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 69. | 2013-16 | Almir Susaj | Dyshohet në shkelje të nenit 3 and 8 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 70. | 2013-17 | Ramadan Rahmani | Dyshohet në shkelje të nenit 1 dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 71. | 2013-18 | Jovanka, Dragan, Milan Vukovic | Dyshohet në shkelje të nenit 1 dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 72. | 2013-19 | U | Dyshohet në shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 73. | 2013-20 | Shaip Gashi | Dyshohet në shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 74. | 2013-22 | Gani Gashi | Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 75. | 2013-23 | V | Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 76. | 2013-24 | Emin Maxhuni | Dyshohet në shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 77. | 2013-25 | Milorad Rajovic | Dyshohet në shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 78. | 2013-26 | Selami Taraku | Dyshohet në shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së | E papranueshme |

| | Lënda | Ankuesi | Subjekti | Rezultati |
|------------|----------------|------------------|---|------------------------------|
| 79. | 2013-27 | Shaban Kadriu | Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 80. | 2014-01 | Nexhat Qubreli | Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 81. | 2014-03 | Lënda A.Z. | Dyshohet në shkelje të nenit 3, 8 dhe 13 i KEDNj-së | E hequr nga lista e ankesave |
| 82. | 2014-04 | Tomë Krasniqi | Dyshohet në shkelje të nenit 1, 3, 6, 14 dhe 17 të KEDNj-së, nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 83. | 2014-06 | Lënda B.Y. | Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 84. | 2014-07 | Fitore Rastelica | Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 85. | 2014-08 | C.X. | Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 86. | 2014-09 | Rifat Kadribasic | Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 87. | 2014-19 | Fahri Rexhepi | Dyshohet në shkelje të nenit 6 dhe nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 88. | 2014-20 | Mensur Fezaj | Dyshohet në shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 89. | 2014-21 | Shefki Hyseni | Dyshohet në shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 KEDNj-së | E hequr nga lista e ankesave |
| 90. | 2014-22 | Ismajl Krapu | Dyshohet në shkelje të nenit 5 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 91. | 2014-23 | Shaip Selmani | Dyshohet në shkelje të nenit 6 të KEDNj-së | E papranueshme |
| 92. | 2014-25 | Nuha Beka | Kontest punësimi | E papranueshme |
| 93. | 2014-28 | Selatin Fazliu | Dyshohet në shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 KEDNj-së | E papranueshme |

SHTOJCA 4**Orari i fushatës informuese dhe aktivitetet e tjera**

| Data | Vendi | Ngjarja |
|-------------|--|---|
| 11/02/14 | PShDNj | Takim me Lydia Gall, Human Rights Watch |
| 19/03/14 | Ndërtesa e Komunës së Prishtinës | Takim me kryetarin e komunës së Prishtinës z. Shpend Ahmeti |
| 27/03/14 | Hoteli Sirius | Tryezë e rrumbullakët, Fondi për të Drejtën Humanitare "Raport mbi krime lufte, krime të motivuara etnikisht dhe politikisht në Kosovë në vitin 2013" |
| 28/03/14 | PShDNj | Takim me Edit A. Nagy, këshilltar i të drejtave të njeriut, OSBE |
| 03/03/14 | ECMI Kosovë | Adrian Zeqiri, drejtor ekzekutiv, Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë - ECMI Kosovë |
| 03/03/14 | Drejtoria e Policisë së Kosovës | Shpend Maxhuni, drejtor i përgjithshëm, Shërbimi Policor i Kosovës |
| 07/04/14 | PShDNj | Takim me z. Joël Mermet, shef i OHCHR, dhe Theodora Krumova, HRO OHCHR |
| 11/04/14 | AAB, Fakulteti Juridik | Takim me dekanin, z. Muhamet Kelmendi |
| 26/04/14 | AAB, Fakulteti Juridik | Prezantim para studentëve të Fakultetit Juridik nga PShDNj-ja |
| 26/06/14 | Zyret kryesore të Bashkimit Evropian, Mitrovica e veriut | Takim me Zlata Radovanovic (ZM), bashkërenduese e zyrës për Kosovë dhe Metohi, Daniela Milic, (DM) zyrtare e zyrës për Kosovë dhe Metohi |
| 07/07/14 | Avokati i Popullit i Kosovës | Takim me z. Sami Kurteshin, Avokat i Popullit i Kosovës |
| 09/07/14 | Zyrat kryesore të Shërbimit Policor Regjional të Kosovës, Zyrat kryesore të EULEX-it, Mitrovica e veriut | Takim me z. Nenad Djuricin, komandant regjional i Kosovës, Shërbimi Policor i Kosovës, Regjioni i Mitrovicës së veriut |
| 15/07/14 | Zyra e kryetarit të komunës së Graçanicës | Takim me zëvendës kryetarin e komunës, dr. Nebojsa Milanovic dhe shefin e kabinetit të kryetarit të komunës së Graçanicës, Sandra Stevic dhe Ivan Tomic |
| 23/07/14 | Zyra e komunës së Leposaviçit | Takim me kryetarin e Leposaviçit, Mitrovica e veriut, z. Dragan Jablanovic dhe znj. Radmila Vukicevic, shefe e Administratës |
| 31/07/14 | Stacioni i Policisë, Leposaviç | Takim me komandantin e Stacionit të Policisë, Leposaviç, Mitrovica e veriut, z. Dragan Stefanovic |
| 04/08/14 | Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Prishtinë | Takim me kryetarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Enver Peci |
| 05/08/14 | Stacioni i Policisë (Qendra), Prishtinë | Takim me komandantin e Stacionit të Policisë, kapiten Driton Imeri |
| 05/08/14 | Stacioni i Policisë (Jugu) | Takim me zëvendës komandantin e Stacionit të Policisë z. Safet Jashari |
| 06/08/14 | Stacioni i Policisë (Qendra), | Takim me zyrtarin e operimeve Regjionale, z. |

| | Prishtinë | Bashkim Spahiu |
|----------|---|--|
| 07/08/14 | Oda e Avokatëve të Kosovës, Prishtinë | Takim me kryetarin e Odës së Avokatëve të Kosovës, z. Ibrahim Dobruna dhe drejtorin ekzekutiv, z. Yll Zekaj |
| 20/08/14 | Padalishtë, Graçanicë | Pjesëmarrje në ceremoninë e fillimit të ndërtimit të objektit për menaxhimin e ndërmarrjeve shoqërore në Graçanicë/Objekti i Inkubatorit |
| 03/09/14 | Biblioteka Kombëtare e Kosovës, Prishtinë | Konferencë Regjionale Shkencore “Kontrabandimi me migrantë – Kosova dhe refleksionet e saj” |
| 21/10/14 | Universiteti i Prishtinës, Mitrovica e veriut | Takim me rektorin, z. Alexander Jovanovic |